

IZLAZNA - OUTGOING  
REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIE E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL  
Ministry of Local Government Administration

Sr. Br. No. 454-139/18  
Date: 14.03.2023

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Qeveria - Vlada - Government**  
Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration



KOMUNA KLINË  
MUNICIPALITY OF KLINA  
STINA KLINA

Nr.No.br. 401-23360/23  
Data-Data-Datum 19.07.2023

Klinë-Klina



Prishtinë, 2023

Në mbështetje të nenit 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 paragrafi 1.4, të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, si dhe Ligjin Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Marrëveshjen e kriteve për financimin e projekteve midis MAPL dhe DEMOS të datës 28.02.2023, si dhe duke u bazuar në Raportin vlerësues për Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021 periudha e alokimit 2023 të aprovuar nga Komisioni i Grantit për Performancë Komunale me dt. 17.10.2022, arrihet kjo:

**MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË PROJEKTIT  
“NDËRTIMI FUNDËRRUESIT PËR SISTEMIN E FILTRIMIT TË UJIT TË PIJES  
NË KLINË”  
NGA SKEMA E GRANTIT PËR PERFORMANCË KOMUNALE**

**Ndërmjet:**

1. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësuar nga Ministri i MAPL-së (në tekstin e mëtejme MAPL),
2. Helvetas Swiss Intercooperation, përfaqësuar nga Menaxheri i Projektit DEMOS (në tekstin e mëtejme DEMOS) dhe,
3. Komunës së Klinës, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna).

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje kanë për qëllim financimin e projektit duke u kujdesur për zbatimin e kriteve, parimeve, procedurave dhe rregullave ligjore të bashkëfinancimit dhe shpenzimit të mjeteve materiale konform dispozitave të kësaj marrëveshje.
2. Marrëveshja parasheh të drejtat dhe detyrimet e palëve në respektimin e rregullave të përcaktuara për bashkëfinancim të projektit, afatet dhe kushtet e tjera kontraktuale për

subjektet juridike, me qëllim të shfrytëzimit të drejtë të grantit të performancës komunale dhe rritjes së efikasitetit të komunave në qeverisjen demokratike, menaxhimin komunal dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarë.

## Neni 2 Objekti i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje ka për objekt bashkëfinancimin e projektit si vijon:

**Ndërtimi fundërruesit për sistemin e filtrimit të ujit të pijes në Klinë**

## Neni 3 Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

1. Shuma totale e projektit në vlerën e paralogaritur është € 650,000.00
2. Shuma totale e ndarë nga buxheti i MAPL-së për këtë projekt është € 200,000.00
3. Shuma totale e ndarë nga buxheti i DEMOS për këtë projekt është € 0.00
4. Komuna nga buxheti i saj financon këtë projekt në shumën prej € 450,000.00
5. Çfarëdo vlere tjetër që tejkalon shumën e paracaktuar të projektit, financohet nga buxheti i komunës.

## Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e MAPL-së

1. MAPL në zbatim të marrëveshjes për kriteret e financimit të projekteve të Grantit të Performancës Komunale ( GPK) të datës 28 shkurt 2023 zotohet që:
  - a) Të sigurojë zotimin e mjeteve financiare sipas nenit 3.2 e kësaj marrëveshjeje. Një kopje e zotimit të mjeteve i dërgohet komunës. Të kryej obligimet financiare në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës.
  - b) Të monitoroj projektin në vazhdimësi dhe bashkëpunon me komunën për implementimin e kushteve të kontratës.
2. MAPL përmes monitoruesit është në kontakt të vazhdueshëm me komunën për këtë projekt dhe në rast se vëren parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës/projektit njofton Sekretarin e Përgjithshëm të MAPL-së, i cili ndërmerr hapat në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. MAPL rezervon të drejtën të ndërpresë këtë Marrëveshje dhe të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm sipas legjislacionit në fuqi, në rast se vërtetohet nga raporti i Auditorit të Përgjithshëm, i cili është kërkuar për Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021, se komuna ka raportuar të dhëna të pasakta apo fiktive të cilat kanë ndikuar në përfitimin e Grantit të Performancës. Në këtë rast të gjitha përgjegjësitë për këtë projekt i takojnë komunës respektive.

4. MAPL nuk mban përgjegjësi në rast të dështimit të projektit për shkaqe të cilat nuk ndërliken me autorizimet e saj, si dhe në rast të ndryshimeve të mundshme të çfarëdo natyre ose shkeljeve që mund të ndodhin gjatë zbatimit të projektit që është në përgjegjësi të komunës.

#### Neni 5

#### Të drejtat dhe detyrimet e DEMOS

1. DEMOS në zbatim të marrëveshjes për kriteret e financimit të projekteve të GPK-së të datës zotohet të siguroj transferin në buxhetin e komunës të shumës financiare të paraparë për projektin sipas nenit 3.3 të kësaj marrëveshjeje.

2. DEMOS, në rast se është financues i projektit, mund të kërkoj informata nga komuna rreth projektit nëse e konsideron të nevojshme. Po ashtu mund të kërkojen informata nga MAPL lidhur me monitorimin e projektit.

3. DEMOS nuk mban përgjegjësi në rast të dështimit të projektit për shkaqe të cilat nuk ndërliken me autorizimet e saj, si dhe në rast të ndryshimeve të mundshme të çfarëdo natyre ose shkeljeve që mund të ndodhin gjatë zbatimit të projekteve që është në përgjegjësi të komunës.

#### Neni 6

#### Të drejtat dhe detyrimet e komunës

1. Komuna obligohet të jap kontributin e saj financiar për zbatimin e projektit në shumën e përcaktuar në nenin 3.4 të kësaj marrëveshjeje.

2. Në rast kur financimi i projektit bëhet nga MAPL, komuna pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet të dërgoj në MAPL informatat e nevojshme për hartimin e PiP (Projekti i Investimeve Publike) me qëllim të zotimit të mjeteve të dala nga kjo marrëveshjeje, sipas Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

3. Nëse pas procedurave të prokurimit, shuma e projektit rezulton më e ulët se vlera e paracaktuar në nenin 3.1 të marrëveshjes, komuna është e detyruar të zvogëlojë kontributin e saj, ndërsa shuma e GPK-së mbetet e njëjtë deri në përmbushjen e vlerës së projektit, ndërsa pjesa e mbetur nga shuma e GPK-së kthehet.

4. Komuna obligohet të zhvillojë projektin në përputhje me këtë marrëveshje dhe kornizën ligjore në fuqi.

5. Në rast kur financimi i projektit bëhet nga MAPL, komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik (OE), të sjellë në MAPL një kopje të kontratës dhe ofertën financiare identike me origjinalin, së bashku me informatat për biznesin me qëllim të nxjerrjes së urdhër blerjes, si vijon:

- çertifikatën për regjistrimin e biznesit;
- çertifikatën e numrit fiskal;
- kopjen e kartelës bankare të OE ose vërtetimi nga banka;
- kopjen e dokumentit identifikues të pronarit të biznesit.

6. Në rast kur financimi i projektit bëhet nga DEMOS, komuna obligohet që të informojë MAPL-në dhe DEMOS-in për vlerën finale të projektit pas përfundimit të procedurave të

prokurimit dhe të dërgoj një kopje të kontratës, ofertën financare dhe raportit të vlerësimit të tenderit.

7. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve dhe komisionin i cili lëshon certifikatën e pranimit të punimeve/pranimin teknik.

8. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë, vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera, në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar (faturën), me kërkesën për realizimin e pagesës të punimeve/furnizimeve të kryera, duke iu referuar kushteve të kontratës.

9. Komuna është e detyruar t'ia sigurojë MAPL-së dhe DEMOS-it kopjet e të gjitha dokumenteve për përmbylljen e projektit, përfshirë:

- kopjen e pranimit teknik/pagesat si konfirmim zyrtar për përfundimin e projekteve dhe
- shumën finale të projektit.

10. Komuna obligohet që të njoftojë MAPL-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit.

11. Komuna obligohet të informojë MAPL-në për dinamikën e punimeve deri në përfundim të projektit.

12. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik dhe para fillimit të realizimit të punimeve në terren, të organizoj ceremoninë inauguruese për realizimin e projektit. Ftesa për pjesëmarrje në këtë ceremoni duhet të dërgohet në MAPL dhe tek Donatorët, së paku 10 ditë para mbajtjes së ceremonisë.

13. Komuna obligohet që para fillimit të realizimit të punimeve në terren të vendosë tabelën informuese (panon) në vend ndërtim, me të gjitha informatat e nevojshme lidhur me projektin duke përfshirë edhe tekstin "Emrin e Projektit, vlerë dhe burimin e financimit, në kuadër të skemës së grantit të performancës".

14. Komuna obligohet që gjatë çdo aktiviteti apo postim promovues lidhur me projektin, të përfshijë "Emrin e Projektit, vlerë dhe burimin e financimit, në kuadër të skemës së grantit të performancës".;

15. Komuna obligohet që pas përfundimit të punimeve në terren, të organizoj ceremoninë përmbjllëse të projekti. Ftesa për pjesëmarrje në këtë ceremoni duhet të dërgohet në MAPL dhe tek Donatorët së paku 10 ditë para mbajtjes së ceremonisë.

16. Në rast të mos respektimit të rregullave dhe standardeve të cekura në pikat 12, 13, 14 dhe 15 të këtij neni nga Komuna, mund të aplikohet neni 10.2 i kësaj marrëveshje.

17. Projektet janë të qasshme në çdo kohë për auditim të rregullt vjetor që kryhet nga Zyra Kombëtare e Auditimit në Kosovë (ZKAK) dhe për auditimet e kërkuara nga DEMOS-i dhe/ose donatorët e tij për projektet e financuara nga buxheti i DEMOS si pjesë e GPK-së.

## Dokumentacioni i nevojshëm i komunës për pagesë të projektit të financuar nga buxheti i MAPL

1. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera të kompletojë dokumentacionin si në vijim:

1.1. Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me Kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare e cila duhet të jetë identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës.

1.2. Vendimin për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimit nga ana e Komunës, në rast se nuk është e definuar me kushtet e veçanta në kontratë.

1.3. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës, komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera të aprovuara (origjinali).

1.4. Faturën nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar (origjinali).

1.5. Sigurimin e ekzekutimit, garancionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës.

### Neni 8

#### Afati i realizimit të projektit

1. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti i financuar nga MAPL të përfundojë brenda vitit fiskal 2023.

2. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti i financuar nga DEMOS të filloj në vitin 2023 dhe të përfundojë brenda vitit fiskal 2023. Në rast se projekti nuk përfundon gjatë vitit 2023, komuna mund t'i bart mjetet e pashpenzuara të GPK-së në vitin 2024 për vazhdimin e projektit sipas kësaj marrëveshje. Fondet e pashpenzuara sipas nenit 3.3 duhet t'i kthehen DEMOS jo më vonë se 25 dhjetor 2024.

3. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, të gjitha detyrimet i bartë Komuna.

### Neni 9

#### Pronësia e projektit

1. Pas përfundimit të projektit dhe pranimit teknik, projekti i financuar sipas kësaj marrëveshje do të transferohet në pronësi të Komunës.

2. Komuna është e detyruar të regjistrojë projektin nën pronësi të saj brenda sistemit të aseteve të Ministrisë së Financave dhe Transfereve (SIMFK).

3. Projekti kalon në pronësi të komunës vetëm pasi që pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, pagesën e fundit me pranim teknik, kur MAPL i kryen të gjitha pagesat e situacioneve dhe në rastet e bashkëfinancimit kur komuna e kryen pagesën - situacionin e fundit me pranim teknik. Me këtë rast, MAPL mbyll llogarinë e investimeve, ndërsa Komuna, pasurinë jo financiare të pranuar nga MAPL e regjistron në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj.

**Neni 10**  
**Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit**

1. Marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas pëlqimit paraprak të MAPL-së, DEMOS-it dhe Komunës.
2. MAPL dhe DEMOS mbajnë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se Komuna nuk i përmbahet kushteve të kësaj marrëveshje.

**Neni 11**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën më të përshtatshme, çdo mosmarrëveshje që buron nga kjo Marrëveshje bashkëpunimi.
2. Nëse nuk do mundet të zgjidhen mosmarrëveshjet me mirëkuptim sipas paragrafit 1 të këtij neni, palët dakordësojnë se kompetencën për të shqyrtuar është gjykata kompetente.

**Neni 12**  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga MAPL, DEMOS dhe Komuna.
2. Kjo marrëveshje është nënshkruar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze në tri (3) kopje autentike, një për secilën nga palët nënshkruese.

**Elbert Krasniqi**  
Ministër i MAPL-së



**Ertan Munoglu**  
Menaxher i projektit DEMOS



**Zenun Elezaj**  
Kryetar, Komuna e Klinës

